

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Ibrahim Idrizi, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Misin Frangu e Ilir Bytyqi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Qëndresa Bobi, në çështjen penale kundër të akuzuarve U.A., D.M. e Sh.A. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Renda, PPI.nr. 239/14 të datës 07.04.2015, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor oral e publik, në prani të të akuzuarve, të mbrojtësve të tyre, dhe atë av. V.J. e A.H., më 19 qershor 2015 shpalli dhe publikisht komunikoi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari**, U.A., i biri i J. dhe nënës Sh. e vajzërisë K., data e lindjes....., në Tetovë, R. e Maqedonisë rruga” ....” hyrja e . numër ..., pa pseudonim, shqiptar, shtetas i R. të Maqedonisë, ka të kryer shkollën fillore, me profesion zdrukthëtar, i pa punësuar, i pa martuar, me gjendje të mesme ekonomike, gjendet në paraburgim prej datës 18.11.2014.

### Ë s h t ë F a j t o r

#### I

Se më 18.11.2014, rreth orës 20:00 në pikën kufitare Glloboqicë, me rastin e ndaljes nga ana e policisë kufitare të veturës BMW me targa .....A. të cilën e drejtonte Sh.A., gjatë kontrollit të veturës dhe të personave, në pjesën e brendshme të të dy kepuçëve të të akuzuarit U.A., janë gjetur të paketuara sasi të substancave narkotike të llojit kokainë me peshë prej 144.38 gram e të cilën substancë narkotike e kishte blerë në Ferizaj, e që e kishte për shitje, por që sasia e narkotikut sekuestrohet nga policia,

- me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne bazë të neneve 4,7,17,21,41,45,46,73,83,273 par. 2 KPRK-së si dhe të nenit 365 te KPP-së,

## **E GJYKON**

Me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 vite e gjashtë muaj dhe me dënim gjobe në shumë prej 2000 euro.

Në dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet koha e kaluar ne paraburgim dhe atë prej datës 18.11.2014 deri sa aktgjykimi te merr formën e prerë por jo me tepër se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin PKR 80/15 te datës 19 qershor 2015.

Dënimin e me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet në format e parapara në nenin 46 te KPK-se, dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim burgimi ashtu që për çdo 20 euro do ti llogaritet një ditë burgimi.

Konfiskohet në mënyrë te përhershme sasia substancës narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 144.38 gram.

Obligohet i akuzuari që Gjykatës, të ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 100 euro në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

## **II.**

### **Të akuzuarit:**

D.M., i biri i B. dhe nënës Gj. e vajzërisë K., data e lindes....., me vendbanim ne Tirane , R. e Shqipërisë, Bashkia Vorë, rruga “ ..... – Vore – Fushë Kruje”, pa numër, pa pseudonim, shqiptar, shtetas i R. te Shqipërisë, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i martuar, prind i 4 fëmijëve, me gjendje te mesme ekonomike, ka qëndruar ne paraburgim prej datës 18.11.2014 deri me 15.12.2014 dhe mbrohet në liri përmes dorëzansisë,

Sh.A., i biri i L. dhe nënës F. e gjinisë S., data e lindes....., me numër personal ....., me vendbanim ne Tetove te R. Maqedonisë, Lagjia “ .....", rruga ....., pa pseudonim, shqiptar, shtetas i R. Maqedonisë, ka te kryer shkollën fillore, me profesion automekanik, pronar i restorantit “ .....", ne Tetovë, i martuar, prind i 3 fëmijëve, me gjendje te mesme ekonomike, 18.11.2014 deri me 15.12.2014 dhe mbrohet në liri përmes dorëzansisë,

Në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së,

### **LIROHEN NGA AKUZA**

Se më datë 18.11.2014 rreth orës 18:30, në restorantin ..... në Ferizaj, i akuzuari D.M. i ka shitur të akuzuarit Sh.A. substancë narkotike të llojit kokainë kurse i akuzuari U.A. e ka poseduar deri në piken kufitare Gllloboqicë, në atë mënyrë që pas marrëveshjes përmes telefonit i akuzuari D.M. lëndën narkotike e ka sjellë në restorantin ....., kurse i akuzuari Sh.A. dhe U.A. kanë ardhur me veturë nga R. e Maqedonisë në këtë restorant, janë takuar me të akuzuarin D.M. prej të cilit e kanë marr lëndën narkotike të llojit kokainë me peshë144.38 gram, e kanë paketuar në pjesën e brendshme të dy këpucëve që i ka mbajtur i akuzuari U.A., e pastaj janë nisur në drejtim të pikës kufitare Gllloboqicë, kështu që rreth ores 20:00 me rastin e ndaljes dhe kontrollit nga ana e policisë kufitare është gjetur substanca narkotike dhe është sekuestruar përkohësisht nga policia,

-meqë nuk është provuar se në bashkëkryerje me të akuzuarin U.A. kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale per këta dy te akuzuar bien në barrë të mjeteve buxhetore.

## A r s y e t i m i

### **1.Historiku i procedurës dhe aktakuza**

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 239/14 të datës 07.04.2015, ndaj të akuzuarve U.A., D.M. e Sh.A., për kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor prokurori i shtetit Rasim Maloku, ka mbetur në tërësi si pranë aktakuzës të paraqitur me shkrim dhe kualifikimit juridik të veprës penale.

Ka deklaruar se me të gjitha provat e paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit janë kryes të kësaj vepre penale, meqë me provat e siguruar në procedurë paraprake me zbatimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, ka rezultuar se të akuzuarit janë takuar në restorantin ..... me datë 18.11.2014, dhe aty kanë bërë shkëmbimin e substancës narkotike, fakti i takimit në këtë restorant nuk është mohuar as nga të akuzuarit e pastaj të akuzuarit Sh.A. dhe U.A. të njëjtën ditë janë kthyer në drejtim të Maqedonisë dhe në piken kufitare Gllboqicë gjatë kontrollit të ushtruar në veturën e të akuzuarit Sh.A., në këpucët e te akuzuarit U.A., policia kanë gjetur substancën narkotike .

Fakti i shkëmbimit të substancës narkotike në mes të të akuzuarve D.M. e Sh.A., vërtetohet edhe nga transkripti i bisedës telefonike të zhvilluar nga i akuzuari D.M., i cili gjatë këtijë intervali kohor, njofton një person se do ti përcjell dy vula për Shqipëri, dy për Maqedoni dhe një për Prishtinë, duke nënkuptuar sasinë e narkotikut të gjetur më pastaj në të dyja këpucët e të akuzuarit U.A..

Në fjalët përfundimtare të palëve i ka propozuar gjykatës qe të akuzuarit ti shpall fajtor për këtë vepër penale dhe tu shqiptoj dënimin e paraparë me ligj.

## **2 Mbrojtja e të akuzuarve**

**I akuzuari U.A.**, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e ka njohur një person të quajtur A. nga Shqipëria dhe atë dy javë para datës 18.11.2004, me të cilin është takuar në Tetovë të Maqedonisë dhe janë marr vesh që të takohen në restorantin ..... në Ferizaj me datë 18.11.2014, me qëllim që i akuzuari të blej substancë narkotike nga ky person. Një ditë përpara kësaj date në restorantin e Sh.A., i ka treguar të njëjtit se të nesërmen do të shkoj në Kosovë për vizitë në familje dhe meqë edhe i akuzuari Sh.A. kishte punë atje, të nesërmen me veturën e Sh.A. kanë shkuar në restorantin ..... dhe aty janë takuar me një person të quajtur D.M. të cilin i akuzuari e kishte takuar njëherë në një restorant në Tetovë, bashkë me këtë person ishte edhe një femër nga Shqipëria, janë ulur në një tavolinë kanë qëndruar për rreth 15-20 minuta, që në ndërkohë Sh.A. ka biseduar me këtë femër që e njëjta të punoj në restorantin e Sh.A. në Tetovë dhe kanë lënë takimin që të nesërmen të kthehet në Kosovë dhe ta marr S.N për tu punësuar në lokalin e Sh.A.it në tetove.

I akuzuari U.A., bashkë me Sh.A. kanë vazhduar rrugën me veturën e Sh.A. dhe kanë hyrë në qendër të Ferizajt ku afër stacionit të autobusëve U.A. ka zbritur nga vetura ndërkaq Sh.A. ka hyrë në një kafiteri për ta takuar një femër, i akuzuari U.A. ka deklaruar se ka shkuar pastaj te stacioni i autobusëve e ka takuar personin e quajtur A. sipas marrëveshjes paraprake, dhe i njëjti e ka njoftuar se sasia e narkotikut është e paketuar në këpucët e tij.

I akuzuari i ka ndërruar këpucët me këtë person, ia ka paguar shumën prej 7500 euro dhe pastaj është kthyer në kafiterinë ku i akuzuari Sh.A. kishte hyrë për ta takuar një femër, në banjën e kësaj kafiterie ka deklaruar se e ka provuar narkotikun, e pastaj me veturën e Sh.A. janë nisur në drejtim të Maqedonisë kështu që në pikën kufitare Gllloboqicë i ka ndaluar policia për procedurë të zakonshme kufitare duke i pyetur se a kanë në posedim ndonjë send të pa ligjshëm e pastaj gjatë kontrollit të ushtruar në këpucët e të akuzuarit U.A. e kanë gjetur sasinë e narkotikut dhe e kanë arrestuar.

Sa i përket veprimeve për sigurimin dhe posedimin e sasisë narkotike, i akuzuari ka deklaruar se i ka ndërmarr vet këto veprime se i akuzuari Sh.A. nuk ka pas njohuri rreth sasisë narkotike dhe në asnjë mënyrë nuk ka qenë i involvuar në këtë veprim, duke shprehur keqardhje se për shkakun e tij është arrestuar edhe i akuzuari Sh.A., me tutje ka shtuar se është përdorues dhe ka vartësi nga substanca narkotike dhe këtë sasi e ka siguruar për përdorim personal.

**I akuzuari D.M.**, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 18.11.2014 bashkë me një shoqe të quajtur S.N. prej Shqiperise ka ardh në Ferizaj në restorantin ..... ku në orët e mbrëmjes është takuar me Sh.A. dhe me një person që ishte në shoqëri me Sh.A., takimi është bërë për të biseduar me Sh.A. lidhur me punësimin e S.N. në lokalin e Sh.A. në Tetovë, në atë mënyrë që Sh.A. dhe S.N. janë marr vesh që ditën e nesërme Sh.A. të vjen në Kosovë ta marr S.N. për të punuar në restorantin e tij. Pas një qëndrimi rreth 15-20 minuta i akuzuari me S.N. kanë shkuar në katin e parë të restorantit e pastaj janë nisur me veturën e të akuzuarit në drejtim të Prishtinës dhe në hyrje të Prishtinës i ka dhënë shenjë një veturës civile për tu ndaluar për ta pyetur vozitësin se ku gjendet restoranti ....., por që personat në këtë veturë janë paraqitur si polic, e kanë kontrolluar duke i sekuestruar sendet personale dhe veturën e të cilat pastaj ia kanë kthyer.

Ka deklaruar në mbrojtjen e tij se me Sh.A. është takuar në Tetovë, në një restorant, është njohur me të ndërkaq takimin në restorantin ..... me datë 18.11.2014 e kanë aranzhuar përmes telefonit, se S.N. ka punuar në një restorant në Tetovë dhe gjatë kësaj kohe i akuzuari ka qenë disa herë atje dhe se S.N. është e moshës madhore kurse marrëveshjen për tu punësuar në restorantin e të akuzuarit Sh.A. e ka bërë vet me këtë person.

Në asnjë mënyrë nuk ka pas njohuri rreth substancës narkotike e cila është sekuestruar nga i akuzuari U.A. dhe se gjatë qëndrimit në restorantin ..... S.N. ka biseduar me Sh.A. për tu punësuar në restorantin e tij, kurse i akuzuari D.M. dhe i akuzuari U.A. aty kanë qëndruar por pa ndërhyrë në këtë bisedë.

**I akuzuari Sh.A.**, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se është pronar i restorantit “ .... “ në Tetovë dhe se me date 18.11.2014 ka ardhur ne Ferizaj me që kishte për tu takuar me personin e quajtur D.M. dhe me një femër të quajtur S.N. me qëllim që S.N. të punoj në restorantin e tij, D.M.in dhe S.N. i ka njohur edhe më herët deri sa S.N. ka punuar në një restorant të

quajtur Korabi në Tetovë. Në lokalën e tij në Tetovë gjatë bisedës me U.A. i ka thënë se ditën e nesërme do të shkojë në Kosovë e U.A. ka kërkuar që të udhëtoj bashkë me të për ta vizituar familjen në Ferizaj, në atë mënyrë që me datën 18.11.2014 me veturën e tij kanë shkuar në restorantin ..... në Ferizaj, janë takuar me D.M. dhe S.N. me të cilin ka biseduar dhe ka arritur marrëveshje që e njëjta të punësohet në restorantin e tij dhe se të nesërmen Sh.A. të kthehet prap në Kosovë ta marrë S.N. dhe të kthehen në Maqedoni. Pas përfundimit të takimit me U.A. janë nisur për Maqedoni por i akuzuari ka deklaruar se kishte për të takuar me një shoqe në Ferizaj afër stacionit të autobusëve ku ajo ka punuar në një kafiteri, në këtë mënyrë kanë hyrë në qendër të Ferizajt, i akuzuari Sh.A. ka deklaruar se ka hyrë në kafiterinë ku ka punuar shoqja e tij kurse U.A. i ka thënë se do të shkojë për një kohë të shkurtër për të vizituar familjarët që ishin diku aty afër.

Pas një periudhe rreth 15 minuta U.A. është kthyer në kafiteri dhe janë nisur në drejtim të Maqedonisë dhe me të arritur në pikën kufitare Glloboqicë gjatë ndaljes për kontroll të rregullt kufitare, policia i kanë njoftuar se duhet të kontrollohet vetura dhe personat, gjatë kontrollit në veturë dhe te i akuzuari nuk kanë hasur diçka të dyshimtë, kurse U.A. e kanë veçuar e pastaj të akuzuarin e kanë arrestuar. Ka deklaruar se U.A. e ka njohur si kamarier dhe shpesh i njëjti ka qenë mysafir në restorantin që e ka udhëhequr i akuzuari Sh.A. në Tetovë, ka deklaruar se nuk ka pas njohuri që i akuzuari U.A. ka blerë apo poseduar substancë narkotike, se në restorantin ..... në Ferizaj, gjatë takimit me D.M. dhe S.N. nuk është biseduar për diçka tjetër përpos bisedës për punësimin e S.N. në restorantin e tij në Tetovë.

### **Qëndrimet e mbrojtësve të të akzuzuarve**

Mbrojtësi i të akuzuarit U.A., avokati V.J. ka konsideruar se veprimet inkriminuese lidhur me sasinë dhe llojin e narkotikut i akuzuarit U.A. i ka bërë i vetëm meqë i ka pranuar të gjitha këto veprime dhe këto janë edhe në harmoni me gjendjen faktike të këtij rasti siç është fakti se lënda narkotike është sekuestruar në trupin e të akuzuarit, por që i akuzuari sasinë narkotike e ka pas për nevojë të veta personale meqë është përdorues i narkotikut dhe vartës nga substanca narkotike e që dëshmohet edhe me raportin mjekësor të datës 30.04.2014, dhe

duke i nisur nga kjo ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Mbrojtësit e të akuzuarve D.M. dhe Sh.A. avokatët G.H. e A.H., kanë deklaruar se nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës dhe pas administrimit të të gjitha provave është vërtetuar pafajësia e këtyre dy të akuzuarve për veprën penale për të cilën akuzohen. Me asnjë provë nuk është vërtetuar përfshirja e këtyre të akuzuarve në veprimin inkriminues duke përfshirë këtu edhe bisedat telefonike të datës 18.11.2014, hyrje – daljet në vendkalimet kufitare, takimi në restorantin ..... në Ferizaj, në mes të të akuzuarve dhe dëshmitares S.N., që ka qenë një takim për punësimin e të njëjtës në restorantin e të akuzuarit Sh.A..

Në fjalët përfundimtare kanë propozuar që Gjykata ti liroj nga aktakuza, për mungesë provash.

### **3.Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata ka paraqitur dhe vlerësuar të gjitha provat e çështjes penale në bazë të të cilave vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv dhe atë

- Transkriptet e përgjimeve telefonike te datës 18.11.2014,
- Hyrje daljet ne vend kalimet kufitare për datat 25.10,2.10 e 18.11.2014,
- Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 18.11.2014,
- Urdhëresa per kthimin e sendeve e datës 23.12.2014,
- Raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes nga Njësia e Forenzikës, raporti i oficerit të policisë kufitare në Gllloboqicë,
- Raporti i ekspertizës nga njësia e shkencave ligjore – analizave kimike, AKF/2014 -4440/2014-3951 te datës 23.02.2015,
- Lexohet raporti mjekësor numër 816 i datës 30.04.2014,
- Procesverbali për kontrollimin ne lokalin ..... i datës 18.11.2014,
- Deklarata e dëshmitares S.N. e dhënë në procedure paraprake me datë 19.11.2014,



#### **4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe të gjeturat faktike të gjykatës**

Gjykata vlerësoi të gjitha provat një nga një dhe në ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën në kuptim të dispozitave të KPPK-së, si dhe provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor dhe konstatoi :

Se është arritur që plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si ne dispozitivin I të aktgjykimit .

Sa i përket të akuzuarit U.A., Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave konstatoi bindshëm se i akuzuari veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, e ka kryer me date 18.11.2014, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e policisë në piken kufitare Gllobiqë në të dy këpucët e tij është gjetur substanca narkotike e llojit kokainë me peshë 144.38 gram. Ky fakt është vërtetuar fillimisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit të dhënë në të gjitha fazat e procedurës penale si dhe nga provat materiale përfshirë raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, fotografitë të marrura në vendin e ngjarjes, raporti i oficerit policor i pikës kufitare Gllobiqë i datës 18.11.2014, si dhe nga raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë e datës 23.02.2015 nga e cila konstatohet se dëshmitë #1, #1.1,#1.2 dëshmia #2, dëshmia #2.1 e #2.2 përmbajnë kokainë të përzier me tetramisol- levamisol me peshë të përgjithshme prej 144.38 gram.

Mënyra, se si i akuzuari U.A. e ka siguruar këtë sasi narkotiku po ashtu është sqaruar nga vet i akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në të gjitha fazat e procedurës penale “ *substancën narkotike e cila më është gjetur e fshehur në këpucë e kam marr në Ferizaj nga qytetar i Shqipërisë i cili quhet A. mbiemrin nuk ja di, jam takuar te stacioni i autobusëve në Ferizaj, dhe para një jave kemi lënë takim te stacioni i autobusëve që të bëjmë ndërrimin e substancës narkotike të llojit kokainë që ai ta fsheh në këpucë dhe kur të takohemi të ndërrojmë këpucët, unë i kam dhënë këpucët e mija A.t ndërsa A. mi ka dhënë të tija, unë*

*kam qenë vetëm”*<sup>1</sup>, për të konfirmuar të njëjtën edhe në deklaratën e tij te dhënë para prokurorit me date 11.02.2015.

Mbrojtja e të akuzuarit U.A. dhe mbrojtësit të tij se sasinë e tillë të narkotikut e ka pas për nevoja personale nga Gjykata u vlerësua si tentim që i njëjti të shmanget nga kualifikimi ligjor i veprës penale sepse do të ishte e pa kuptueshme, po në anën tjetër edhe i pa vërtetuar ky fakt, si të kuptohet ndryshe kur në këpucët e të akuzuarit U.A. është gjetur sasia prej 144.38 gram e llojit kokainë të cilin siç ka deklaruar i akuzuari e ka blerë për shumën prej 7500 euro, transportimi i të njëjtës prej Kosovës në Maqedoni, por vetëm si veprim në kuptimin e shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të substancave narkotike.

## II.

Sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, Gjykata po ashtu analizoi të gjitha provat materiale, mbrojtjen e të akuzuarve, deklaratën e dëshmitares S.N. dhe pasi i vlerësoi një nga një dhe në ndërlidhje njëra me tjetrën për të konstatuar gjendjen faktike e që kjo pjesë e aktgjykimit do të përqendrohet pikërisht në trajtimin dhe gjetjen e fakteve lidhur me inkriminimin apo jo të të akuzuarve D.M. e Sh.A. në veprën penale.

Fillimisht do të trajtohen deklaratimet e të akuzuarve të dhëna në procedurë paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor për të u ndërlidhur edhe me provat materiale të qështjes penale.

I akuzuari U.A. në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se substanca narkotike me dt. 18.11.2014 i ja kanë sekuestruar policia në piken kufitare në Gllaboqic, e që të njëjtën e kishte blerë në Ferizaj nga një person i quajtur A. nga R. e Shqipërisë, dhe atë te Stacioni i Autobusëve ku e kishin lënë marrëveshjen për të u takuar, se i akuzuari Sh.A. nuk ka qenë në njohuri për këtë fakt, se gjatë kohës kur e ka marrë drogën prej këtij person, Sh.A. ka qëndruar në një kafiteri me një shoqe të tij, ndërkaq në Restorantin ..... në Ferizaj ku ka qëndruar bashkë me Sh.A. dhe të akuzuarin D.M. në shoqëri edhe me një femër të quajtur S.N. kanë biseduar për punësimin e S.N. në restorantin e Sh.A..

---

<sup>1</sup> Pjesë e deklarimit të të akuzuarit U.A. të dhëna para policisë në prani të avokatit me 19.11.2014

I akuzuari Sh.A., nuk e ka mohuar faktin se prej Tetovës me veturën e tij bashkë me të akuzuarin U.A. kanë ardhur në Ferizaj, e që U.A. i kishte thënë se do të vizitoj një të afërm të tij në Ferizaj, dhe në Restorantin ..... janë takuar me D.M. dhe një shoqe të tij të quajtur S.N. dhe është marrë vesh që e njëjta të punësohet në restorantin e tij, e pas përfundimit të takimit ka shkuar afër Stacionit të Autobuzve ku është takuar me një shoqe të tij, kurse i akuzuari U.A. pasi është kthyer nga vizita e familjarëve, kanë vazhduar rrugën në drejtim të pikës kufitare Glloboqic për të shkuar në Maqedoni.

Ka deklaruar se nuk ka qenë në njohuri që i akuzuari U.A. posedonte substancë narkotike e që gjatë kohës sa ka qëndruar me të nuk ka biseduar fare me asnjë person lidhur me narkotikët, ndërkaq nuk ka mundur të dijë se qka ka vepruar i akuzuari U.A. kur është ndarë prej tij për një kohë te Stacioni i Autobusëve.

Faktin se të akuzuarit janë takuar në Restorantin ..... nuk e ka mohuar as i akuzuari D.M., e këtë fakt e ka konfirmuar edhe dëshmitarja S.N. në procedurë paraprake, dhe se kanë biseduar për punësimin e S.N. në restorantin e të akuzuarit Sh.A. në Tetovë.

Po ashtu nuk është mohuar fakti se takimi në Restorantin ....., D.M. me Sh.A. e kanë aranzhuar përmes bisedës telefonike, por nga deklaratat e të akuzuarve dhe deklarata e dëshmitares S.N. nuk vërtetohet që këta të kenë zhvilluar bisedë rreth narkotikut apo me U.A., e që këtë fakt e ka pohuar edhe i akuzuari U.A. në të gjitha fazat e procedurës duke e përfshirë edhe deklaratën në polici të dhënë me njëherë pas arrestimit. Kur këtyre u shtohen edhe provat materiale siq janë procesverbali i policisë kufitare në Glloboqic, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, dhe sekuestrimi i lëndëve narkotike vërtetohet se lënda narkotike është gjetur në këpucët e të akuzuarit U.A. dhe me këtë konstatohet përfundimisht se nuk është provuar që të akuzuarit D.M. dhe Sh.A. të kenë kryer në bashkëkryerje me të akuzuarin U.A. veprën penale për të cilën akuzohen.

Rrethana e ardhjes së të akuzuarve D.M. dhe Sh.A. në Kosovë me dt. 18.11.2014 dhe takimi i tyre në Restorantin ..... në praninë edhe të akuzuarit U.A., afriori nuk mund të kuptohet si takim për qëllime inkriminuese, sepse nga të gjitha provat materiale nuk rezultoi ndonjë veprim inkriminues nga këta të akuzuar. Biseda telefonike e siguruar me zbatimin e masave të fshehta ligjore, e të akuzuarit D.M. me një person të pa njohur të zhvilluar me dt. 18.11.2014 në ora 18:35 kur i njëjti njofton këtë person se do të i vendos dy vula se i ka katër dhe do të i nisë dy për Maqedoni, dy për Shqipëri e një për Prishtinë, në asnjë provë nuk vërtetohet se ka të bëjë me shitjen a po blerjen e substancës narkotike, siq del pra nga gjendja

e fakteve i akuzuari D.M. është ndaluar nga policia në hyrje të Prishtinës, është kontrolluar vetura e tij, përfshirë edhe vetë të akuzuarin dhe personin që ishte në shoqëri me të dhe është konstatuar se nuk është gjetur ndonjë send i pa ligjshëm që do të shërbente si provë për veprën penale, po ashtu edhe kontrolli policor i ushtruar në Restorantin ..... në Ferizaj – në dhomën ku mendohej se ka qëndruar i akuzuari D.M. nuk ka rezultuar me ndonjë provë të dyshimtë për veprën penale.

Barra e të provuarit i takon organit të akuzës të cilën gjykata e vlerëson në bazë të ligjit, ndërkaq çdo dyshim për provat duhet të shkojë në favor të të akuzuarit, ndërkaq prezomimi i pafajësisë nënkupton që gjykata nuk duhet që çështjes konkrete të i qaset me idenë e prejudikimit të fajësisë-se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, parime këto fundamentale të procedurës penale të garantuara edhe me Konventat Evropiane për të Drejtat dhe Lirit e Njeriut.

Gjykata me rastin e vendosjes në një qështje penale, ka për obligim ligjor që të i provoj gjithanshëm dhe në mënyrë të pa kontestuar të gjitha faktet të cilat janë në disfavor dhe në favor të të akuzuarit dhe duke u ndërlidhur me prezumimin e pafajësisë dhe me parimin “in dubio proreo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për qështjen duhet të interpretohen në favor të të akuzuarit , dhe duke u nisur nga faktet e konstatuara të rastit konkret gjykata nuk gjeti fakte e prova të kontestueshme lidhur me pjesëmarrjen e të akuzuarve D.M. dhe Sh.A. në veprën penale për të cilën akuzohen me akuzën e prokurorit.

Po ashtu gjykata duke pasur parasysh edhe faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” në drejtim të të akuzuarve D.M. dhe Sh.A. nuk janë argumentuar me asnjë provë dhe me siguri të plotë, përtej dyshimit të bazuar “ beyond rias an able doubt” dhe pasi që nuk u arrit diçka e tillë dhe u vërtetua se këto nuk ekzistojnë, kurse faktet e vërtetuara që janë në favore “in favoren” të të akuzuarve u konstatua se të tillat ekzistojnë andaj edhe i lirojmë nga akuza siç u cekë në dispozitivin II – pjesën liruese të aktgjykimit.

## **5. Vlerësimi i veprimeve të të akuzuarit U.A.**

Si rezultat i vlerësimit të të gjitha provave, gjykata konstatoi në mënyrë të sigurt se në veprimet e të akuzuarit U.A. qëndrojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive që formojnë figurën e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, për të cilën veprë penale i akuzuari është penalisht përgjegjës andaj dhe e shpalli fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **6. Përcaktimi i dënimit për të akuzuarin U.A.**

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjeti se i njëjti nuk është i njohur si kryes i veprave penale të llojit të tillë apo të llojit tjetër (në territorin e R. Kosovës), ndërkaq si rrethana rënduese gjykata pati parasysh rrezikshmërinë abstrakte dhe pasojat që shkakton përdorimi i narkotikëve në shëndetin e njerëzve, përmes shpërndarjes dhe shitjes dhe ndikimi i përdorimit të substancave të tilla në shëndetin mental dhe fizik të përdoruesve e në veçanti të gjeneratës së re, mënyrën dhe rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale- paketimi dhe vendosja e narkotikut në këpucë me qëllim që ta transporton për shitje në shtetin tjetër, duke i dhënë kështu veprës penale kahje të përmasave ndërshtetërore.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me burgim dhe me gjobë ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i parapare në nenin 41 të KPRK-se, njëherit do të ndikojë që në të ardhmen i akuzuari mos të kryej vepra të tilla dhe të tjera penale – si preventivë speciale dhe njëherit do të ndikojë të personat e tjerë në parandalimin e kryerjes së veprave të tilla penale – preventiva gjenerale.

## **7. Llogaritja e paraburgimit të akuzuarit U.A.**

Ne dënimin e shqiptuar te akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim prej datës 18.11.2014 sipas nenit 83 parag 1 te KPRK-së.

#### **8. Konfiskimi dhe shpenzimet e procedurës penale**

Ne baze te nenit 273 parag 5 te KPRK-së, konfiskohet ne mënyrë te përhershme substanca narkotike e llojit kokain ne peshe prej 144.38 gram.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe te paushallit gjyqësor është i bazuar ne nenin 450 e 453 te KPPK-së.

Nga te cekurat me lartë u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR-80/15**  
**Më, 27 qershor 2015**

Sekretare juridike  
Qëndresa Bobi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
**Ibrahim IDRIZI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.